



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I LARTE GJYQESOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr.527, datë 24.09.2024**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 244 DHE NR.246, DATË 02.05.2024, PËR KANDIDATEN ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 24.09.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e znj. {...} nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 244 dhe nr.246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidates për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për shkak të tërheqjes së kandidates nga kandidimi,

**VËREN**

**I. TË DHËNA MBI KANDIDIMET**

1. Me Vendimin nr. 244, datë 02.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në **Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm** për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile.*

1.1 Me Vendimin nr. 246, datë 02.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në **Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm** për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile.*

2. Në këtë procedurë të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, afati i kandidimit është përcaktuar data 16.05.2024.

3. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

## II. TË DHËNA MBI PROCEDURAT

4. Me Vendimin nr. 266, datë 24.05.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

- “1. *Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Caktimin e relatorit si më poshtë: 16.Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro.*

5. Më datë 27.05.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

6. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6.1 Referuar sa më lartë si dhe bazuar Vendimit nr. 361, datë 29.07.2024 “Për deklarin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Alban Toro”, Këshilli, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, të vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar, si dhe vendimin nr. 266, datë 24.05.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr.245, 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, me Vendimin nr. 509, datë 24.09.2024 "Për një

*ndryshim në vendimin nr. 266, datë 24.05.2024, si më poshtë: Caktimin e z. Klodian Kurushi, si relator për kandidatin znj. {...}*

7. Më datë 19.02.2024, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 11.03.2024, pranë ILDKPKI-së

9. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

10. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidaten znj {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Këshilli, me Vendimin nr. 339, datë 09.07.2024, ka vendosur:

*1. Verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*

*2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimit të Këshillit nr.244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024.*

### **III. TË DHËNA MBI KËRKESËN PËR TËRHEQJEN NGA KANDIDIMI**

11. Në vijim të procedurës së verifikimit të kriterëve të tjera ligjore të kandidimit të cilat lidhen me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës, kandidatja znj. {...}, me anë të shkresës së datës 09.07.2024 protokolluar në Këshill me aktin nr. 3593 prot., ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga kandidimi për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke parashtruar se: “Unë e nënshkruara {...}, aktualisht Gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, paraqes pranë Jush Kërkesën për hequr dorë në lidhje me kërkesat e bëra nga ana ime, për kandidim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane, për vendet e shpallura me nr.244 dhe 246 date 02.05.2024 nga ana e KLGJ-së. Duke qenë se formulari i deklarimit të pasurisë në lidhje me këto vende, nuk është plotësuar nga ana ime brenda afatit 21 ditor (për arsye familjare

*që lidhen me një anëtar të ngushte të familjes që dhe ndërroi jetë), paraqes kërkesën për heqje dore nga kandidimi për këto dy vende me nr.244 dhe 246 datë 02.05.2024”.*

12. Në rrethanat sa sipër, përgatitet ky vendim bazuar në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), ku përcaktohet se: “*Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”.*

13. Në Mbledhjen e datës 11.07.2024 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për kandidaten znj. {...}, si dhe po ashtu, si të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja për t’u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 244 dhe nr.246 datë 02.05.2024, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

#### **IV.SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATES**

14. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të gjitha niveleve, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit për Statusin.

15. Këshilli, në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 48 të Ligjit për Statusin, procedura administrative për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t’u tërhequr nga kandidimi buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit: “*Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka”.* Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin 94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

16. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Vendimin 75/2019. Kështu, në Kreun V, Seksioni B, pika 6, të tij, përcaktohet se: *“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së verifikimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit”*.

17. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara, konstatohet se kandidatja znj. {...}, brenda afatit të kandidimit ka paraqitur kërkesën për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për ngritjes në detyrë për këtë pozicion të lirë, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim final, kandidatja u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë ngritje në detyrë, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit një kërkesë me shkrim, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i saj për t’u tërhequr nga kandidimi.

## **V. KONKLUZIONE**

18. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidatja znj. {...}, të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e saj për t’u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 244 dhe nr.246 datë 02.05.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë candidate.

## **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

## **V E N D O S I :**

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**